

LULJETA NANO



Sekretare e Përgjithshme në KLSH që nga tetori i vitit 2013.

Lindur në 1961. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë, në Jurisprudence dhe CIPFA në Institutin e Çertifikimit për Financë dhe Kontabilitet.

Pedagoge e jashtme në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik. 28 vite eksperiencë pune. 21 vitet e fundit në KLSH, në pozicionet Audituese e Lartë dhe Kryeaudituese. Drejtor Drejtorie nga viti 2012.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i Financave Publike.

KLSH, INTEGRITETI I QEVERISJES, AUDITIMI I ETIKËS DHE INTEGRITETITⁱ

nga Luljeta Nano

KLSH luan një rol kritik në promovimin e menaxhimit të shëndoshë të financave publike që tenton në një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme.

Hapat e ndërmara deri tani nga KLSH, drejt modernizimit dhe me një vizion të ri, synojnë zhvendosjen nga një rol observues në një rol proaktiv dhe përmirësues të situatës për rritjen e përgjegjshmërisë dhe besueshmërinë se publikut ndaj qeverisjes.

Menaxhimi i fondeve publike është çështje besimi dhe ne shoqëritë demokratike publiku dhe qytetarët tregojnë interes, dhe janë pjesëmarrës aktivë në çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike. Qytetarët kërkojnë transparencë, integritet dhe kompetencë prej atyre që i përfaqësojnë dhe qeverisë e cila menaxhon fondet publike.

E parë në këtë këndvështrim, Qeveria është i vetmi autoritet i cili ka monopolin e ofrimit të shërbimeve ndaj popullatës dhe ndaj së cilës kjo e

fundit duhet të ketë besueshmëri që menaxhimi i fondeve publike po kryhet me transparence dhe integritet.

Integriteti i qeverisjes është një nga shtyllat bazë të menaxhimit efektiv të financave publike por njëkohësisht është parakusht për besimin e publikut ndaj qeverisë. Mungesa e besimit të publikut ndaj qeverisë afekton drejtpërsëdrejti autoritetin e saj.

Për këtë punonjësit publikë duhet të jenë të përgjegjshëm para qytetarëve për sjelljen e tyre në ushtrimin e funksioneve publike.

Kohët e fundit KLSH, ka ndërmarrë hapa konkrete dhe një sërë iniciativash referuar rritjes së rolit për instalimin në institucionet publike të etikes, integritetit për luftën ndaj korrupsionit.

Korrupsioni në kuptimin e gjerë është shkelje e integritetit, dhe politikat antikorrupsion duhet të synojnë në ngritjen e sistemeve të qëndrueshme dhe mbrojtjen e integritetit në sektorin publik.

Kudo në bote vitet e fundit është ndërmarrë insiativa për promovimin e etikës dhe integritetit në sektorin publik.

Në Hollandë si rezultat i një bashkëpunimi institucional–Gjykata e Auditimit, Zyra kombetare e Promovimit të etikës dhe integritetit në sektorin publik kanë zhvilluar një instrument për integritetin e cili është targetuar për të parandaluar shkeljet e integritetit, aktet korruptive dhe mashtrimin në organizate.

Ky instrument lejon organizatat qeveritare të vete vlerësojnë nëse politikat e integritetit në organizate ekzistojnë nëse ka fusha dhe sektorë vulnerabel ndaj shkeljeve të ligjeve dhe rregullave dhe marrjen e masave të disenjuara enkas për promovimin e integritetit si dhe zbatimin e një politike integriteti efektive.

Në këtë kontekst integriteti është i lidhur ngushte me marrjen e masave për të krijuar një ambient jo korruptiv, si dhe implementimin e një kulture dhe etike në organizata publike,

Në këtë kuadër KLSH i është bashkuar iniciativës së ndërrmarë nga Gjykata Hollandeze e Auditimit për kryerjen e vetevlerësimit të integritetit në institucionin e KLSH-së brenda vitit 2013, i cili do të synojë në testimin e sistemit të integritetit, evidentimin e fushave vulnerabel dhe me risk si dhe hartimin e planit të masave që do të merren për forcimin e sistemit të etikës si dhe përmirësimin e menaxhimit të integritetit në KLSH.

Po kështu së fundi KLSH, është bërë pjesë e Task Forces “Për auditimin e etikës” i Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI).

Padyshim nëpërmjet anëtarësimit të Institucionit të KLSH-së si anëtare e Task Forcës synon në shtrirjen e auditimeve mbi rregullaritetin dhe eficienten e infrastrukturës etike në institucionet publike duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikave për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë të vazhdueshme dhe jo politika të përkohshme por të jenë pjesë e menaxhimit të institucioneve publike.

Nëpërmjet kryerjes së auditimeve të Etikës dhe Integritetit në njësitë e sektorit publik, do të tentohet drejt parandalimit të akteve korruptive nën parimin “ më mirë të parandalosh se sa të shpenzosh për dëmin e shkaktuar” duke balancuar marrjen e masave në rastin e shkeljeve të integritetit dhe masave të cilat do të synojnë në parandalimin e shkeljeve.

Nëpërmjet aplikimit të instrumentit të vetevlerësimit të Integritetit në institucionin e KLSH-së si dhe Anëtarësimit në Task Forcën e EUROSAI-it “Mbi Auditimin e Etikës” KLSH synon që të forcojë infrastrukturën etike brenda vetë institucionit, dhe në këtë mënyrë të promovojë integritetin dhe etikën në institucionet e sektorit publik duke “udhëhequr sipas shembullit”

duke ndërrmarë misione auditimit për vlerësimin dhe inkurajimin e ngritjes dhe funksionimit të sistemeve efektive të integritetit dhe duke përmbushur një nga objektivat kryesore që është forcimi i besimit të publikut në qeverisjen e sektorit publik.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 25 Qershor 2013